



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 14 Shtator 2022

Nr.23

VENDIM
PËR

“SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE
NR.03, DATË 15.07.2022, DREJTUAR KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE, PËR VENDOSJE SANKSIONI ADMINISTRATIV”

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 14.09.2022, me pjesëmarrjen e:

| | | |
|-----------------|---|---------|
| Ledio BRAHO | - | Relator |
| Elvin LAKO | - | Anëtar |
| Elvis ÇEFA | - | Anëtar |
| Ilirjan RUSMALI | - | Anëtar |
| Koli BELE | - | Anëtar |

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga administrata e KQZ-së,

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKTI: Vendosja e sanksionit administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa, kandidate për kryetare bashkie, njëkohësisht kryetare e bashkisë Lushnjë, për zgjedhjet e pjesshme të datës 06 Mars 2022

BAZA LIGJORE: Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; neni 34, shkronja “b” dhe neni 35 të vendimit nr.3, datë 06.11.2020 të

Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”; vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vënë në lëvizje Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve me kërkesën e tij nr. 3, datë 15.07.2022, me objekt vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa, kandidatë për kryetare bashkie, njëkohësisht kryetare e bashkisë Lushnjë, për zgjedhjet e pjesshme të datës 06 Mars 2022.
2. Kërkesa u paraqit në përfundim të hetimit administrativ të kryer nga Komisioneri, bazuar në denoncimin me numër ID 3606, të datës 26 shkurt 2022, të depozituar në portalin e denoncimeve nga organizata “Qendresa Qytetare” kundër zj. Eriselda Sefa, kandidat për kryetar të Bashkisë Lushnjë, z. Haki Çako Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”. “Qendresa Qytetare” denonconte subjektet e sipërcituar për shkelje të dispozitave të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr.9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, për shkak se kanë marrë pjesë (sipas denoncimit) në një veprimtari të ndaluar, ka vizituar punimet e investimeve mbi lumin Shkumbin, të financuara nga fondi i AKMC, ku kanë promovuar investimet me interes publik, si dhe nuk kanë njoftuar paraprakisht në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së për kryerjen e veprimtarisë.
3. Komisioneri ka konkluduar në analizën ligjore të çështjes se “*Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me veprimtari me fonde të vëna rishtazi dhe as me fonde publike të transferuara jo sipas planit buxhetor të miratuar, pasi investimi dhe procedurat për realizimin e projektit “Mbrojtja nga gërryerjet e lumit Shkumbin, në krahun e majtë të zonës Thanasaj”, kanë filluar 7 (shtatë) muaj para datës së zgjedhjeve, vërtetuar kjo me shkresën nr. 5127/6, datë 27.07.2021 “Mbi rehabilitimin e objekteve të mbrojtjes nga përmbytja”, shkresat nr. 1464/7, datë 16.08.2021 dhe nr. 192/1, datë 30.08.2021 “Mbi nevojën e prokurimit të projekteve prioritare të ndërhyrjeve në objektet e mbrojtjes nga përmbytja” si dhe urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor në Ministrinë e Mbrojtjes nr. 1862, datë 21.12.2021 “Për lidhje dhe zbatim kontrate”. Komisioneri është shprehur se “Kryetari i bashkisë Lushnjë, njëkohësisht edhe kandidat për kryetar bashkie, zj. Eriselda Sefa është paraqitur pranë zonës ku po kryhet investimi, në kuadër të vizitave*

inspektuese të herëpashërëshme që kryetarja e bashkisë kryen, në zbatim të funksioneve dhe detyrave të njësisë të vetëqeverisjes vendore. Veprimtaria e mësipërme nuk konsiderohet e ndaluar, pasi është në përmbushje të detyrave funksionale të Kryetarit të Bashkisë. Megjithatë, në kundërshtim me çfarë ishte planifikuar nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, kryetarja e bashkisë njëkohësisht dhe kandidat për kryetar bashkie, e propozuar nga ana e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, ka shfrytëzuar këtë takim për kryerjen e fushatës zgjedhore.”, thekson Komisioneri në vendimin e tij nr.180, datë 30.06.2022.

4. Lidhur me pozicionin e z. Haki Çako, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Komisioneri doli në përfundimin se *“veprimtaria e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, pasi z. Çako ka qenë në kryerjen e detyrave të tij funksionale.”*
5. Komisioneri ka arsyetuar se: kushti që duhet të vërtetohet nga hetimi është që veprimtaria të jetë kryer në favor të subjektit zgjedhor d.m.th. subjekti zgjedhor të ketë siguruar përfitim elektoral nga shkelja dhe që ky i fundit të mos ketë marrë masa për ndërprerjen e shkeljes, pas marrjes dijeni, në rastin konkret në favor të zj. Sefa. Nuk rezulton e provuar se cili prej institucioneve ka ftuar në këtë takim përfaqësuesin e partisë politike dhe deputetin z. Taulant Balla. Pjesëmarrja e z. Taulant Balla në takimin e zhvilluar i jep atij karakter politik dhe mbështetës apo promovues ndaj kandidatës së Partisë Socialiste për kryetar të bashkisë Lushnjë. Komisioneri ka çmuar se nga vlerësimi i përgjithshëm gjatë hetimit administrativ të kryer, del qartazi përfitimi elektoral në favor të kandidatës për kryetare bashkie zj. Eriselda Sefa. Për këtë arsye, ai i është drejtuar KAS-it me kërkesën për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në përputhje me nenin 172, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
6. Pas paraqitjes së kërkesës nr.3, datë 15.07.2022 të Komisionerit, KAS-i caktoi me short anëtarin Ledio Braho si relator të çështjes dhe në seancën e datës 20.07.2022, e cila u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së dhe të përfaqësuesve të organizatës “Qendresa Qytetare” (palët e tjera të njoftuara rregullisht, në mungesë) vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim dhe caktimin e seancës së shqyrtimit në datën 14.09.2022, ora 11.30.
7. Në seancën e shqyrtimit u paraqitën dhe parashtruan pretendimet e tyre:
 - Administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj;

- Organizata “Qendresa Qytetare”, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, z. Rigels Xhemollari.
- Kandidatja për kryetare e Bashkisë Lushnjë zj. Eriselda Sefa e njoftuar rregullisht nga administrata e KQZ-së, është në mungesë.

8. KAS-i mori në shqyrtim, këqyri dhe administroi me cilësinë e provës:

- denoncimin nr. ID 3606, datë 26 shkurt 2022 të organizatës “Qendresa Qytetare” (sipas paraqitjes në portalin e denoncimeve dhe paraqitjes në protokollin e KQZ-së);
- shkresën nr. 1635 prot., datë 07.03.2022 drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe shkresën nr. 1638 prot., datë 07.03.2022 drejtuar Bashkisë Lushnjë;
- shkresën nr.398/1 prot., datë 03.03.2022 të z. Haki Çako në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- shkresën nr.398/5 prot., datë 18.05.2022 të z. Haki Çako në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- prapësimet e organizatës “Qendresa Qytetare” administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 2459 prot., datë 25.05.2022;
- shkresën e Bashkisë Lushnjë të datës 23.05.2022, nr. 4303/1 prot., drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, protokolluar me nr.2383/2, datë 24.05.2022;
- vendimin nr. 180, datë 30.06.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Provat Link:
 - <https://fb.watch/bkKNTt4UdL/>
 - <https://www.facebook.com.eriselda.sefa1/posts/119908377272722>
 - <https://www.facebook.com/b.taulant/posts/485733019584909>

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe pas vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

Pika 1, e nenit 92 të Kodit Zgjedhor ka dhënë kuptimin e veprimtarisë publike në fushatë. Sipas këtij përkufizimi, “formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”.

Që veprimtaria të quhet publike, sipas kuptimit të kësaj dispozite, ajo nuk duhet domosdoshmërisht të jetë miting, tubim, mbledhje apo grumbullim i thirrur dhe i organizuar me synim pjesëmarrjen e publikut. Mjafton që ajo të jetë e “hapur”, domethënë të mos zhvillohet “pas dyerve të mbyllura”. Nuk ka nevojë që publiku apo media të thirren, të ftohen apo të mobilizohen për të marrë pjesë në veprimtari që ajo të quhet publike. Mjafton që ata të kenë akses dhe të mos ndalohen kur i qasen asaj. Nga ana tjetër, veprimtaria bëhet publike sipas kuptimit të kësaj dispozite, edhe në rastet kur ajo zhvillohet “pas dyerve të mbyllura”, por ama synon dhe realizon në fakt informimin e publikut për temat, diskutimet dhe përfundimet e agjendës së saj.

Për të kuptuar nëse veprimtaria e denoncuar me denoncimin nr. ID 3606, të datës 26 shkurt 2022 është veprimtari publike ose jo, është e nevojshme të këqyren dhe çmohen pamjet dhe fotot që i referohen kësaj veprimtarie dhe që janë referuar si prova në denoncim. Pamjet dhe fotot shfaqin një vizitë/inspektim në fshatin Thanasaj për një investim në lumin Shkumbin të financuar nga AKMC. Pjesëmarrës si bashkëbisedues në takim janë kandidatja e PSSH për kryetare të bashkisë Lushnjë, zj. Eriselda Sefa, drejtuesi politik për qarkun e Fierit, Taulant Balla dhe Drejtori i Agjencisë Kombëtare së Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako. Takimi duket i hapur, spontan dhe pa protokoll. Për më tepër, nuk ka asnjë indicie që të lërë të kuptohet se regjistrimi në video i veprimtarisë dhe fotot e nxjerra prej saj të jenë të improvizuara apo të kryera nga duar amatore. Përkundrazi, në pamjet video shfaqen edhe individë të tjerë që duken si publik në raport me këtë vizitë/inspektim të tre bashkëbiseduesve të sipërcituar.

Mesazhet e përcjella nga pjesëmarrësit në këtë takim janë të qarta:

- “Në këtë aspekt është një projekt në bashkëpunim me Bashkinë e Lushnjës dhe Ministrinë e Bujqësisë që vjen në ndihmë të banorëve” (Drejtori i Përgjithshëm i AKMC)
- “Është gjetur si një zgjidhje e drejtpërdrejtë investimi në tetë segmente për të eliminuar të gjithë gërryerjen e lumit Shkumbin në drejtim të banesave të banorëve të Thanasaj” (Drejtori i Përgjithshëm i AKMC)
- “Për ne është shumë e rëndësishme pasi nuk mund të bënim investimin në rrugë pa bërë investimin te prita sepse çdo investim te rruga pa investimin te pritat do të ishte investimi çuar dëm” (Drejtuesi Politik i Qarkut Fier)
- “Me investimin te pritat, do të nisë investimi te rruga e fshatit Thanasaj ... që mbetet një nga detyrimet kryesore që kjo bashki ka në këtë njësi” (Drejtuesi Politik i Qarkut Fier)
- “Ky investim është shumë i rëndësishëm se ne për çdo shi, duhet të rrinim në gatishmëri në këtë zonë, pasi gjithmonë ishte në situatë gati për përmbytje” (kandidatja e PS për kryetare bashkie)

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në vendimmarrjen e tij ka argumentuar se “Nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se zj. Eriselda Sefa, kandidat për Kryetar të Bashkisë Lushnjë, e propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, duke vizituar punimet e investimeve mbi lumin Shkumbin të financuara nga fondi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe duke promovuar investimet e ardhshme, ka përdorur burime publike në mbështetje të fushatës së saj zgjedhore, në kuptim të nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor. Rezultoi e provuar se, veprimtaria e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, pasi z. Çako ka qenë në kryerjen e detyrave të tij funksionale”.

KAS pranon argumentin e Komisionerit sa i përket kandidatës së Partisë Socialiste për Bashkinë e Lushnjës, por nuk e gjen të plotë argumentin e Komisionerit në lidhje me Drejtorin e Përgjithshëm të AKMC. Është e vërtetë që veprimtaria e Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC nuk përbën veprimtari të ndaluar sipas nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, por këtu duhet t’i referohemi pikave 1, 2 dhe 3 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor në lidhje me raportimin në KQZ të aktivitetit objekt shqyrtimi administrativ që parashikojnë se:

“1. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.

2. Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv). Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

3. Raportimi sipas pikës 1 të këtij neni kryhet nëpërmjet ndërfaqes për raportimin e veprimtarive publike, e cila mbahet dhe administrohet nga KQZ-ja. Personat përgjegjës marrin akses të personalizuar te kjo ndërfaqe dhe hedhin të dhënat për datën dhe orën e veprimtarisë, llojin e saj, tematikën, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin. Informacioni sipas kësaj pike është i aksesueshëm nga të gjithë përdoruesit e ndërfaqes nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve”.

Pikërisht në zbatim të kësaj dispozite të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator pranë KQZ ka miratuar vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, i cili në pikat 1 dhe 4 të nenit 4 të tij, parashikon se:

“1. Ndërfaqja e raportimeve përfaqëson faqen zyrtare të internetit të zotëruar dhe në shërbim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe të institucioneve të tjera për ushtrimin e detyrave e të përgjegjësive ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në këtë vendim. Ndërfaqja krijohet, administrohet dhe përditësohet nën autoritetin dhe përgjegjësinë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

...

4. Raportimi në ndërfaqe duhet të kryhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë ose të aktivitetit publik. Raportimi në ndërfaqe, në emër dhe për llogari të subjekteve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 3, të këtij vendimi, bëhet nga sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore dhe vendore (monokratike ose kolegjiale), drejtorët e përgjithshëm apo drejtuesit më të lartë administrativë për agjencitë dhe institucionet nën varësinë e Kryeministrit, drejtuesit ekzekutivë të shoqërive tregtare në të cilat shteti ka pjesëmarrje në kapitale, kuota e aksione më shumë se 50 për qind të aksioneve, drejtuesit

ekzekutivë të ndërmarrjeve shtetërore, enteve publike, si dhe Administratorët e Njësive Administrative”.

Për aktivitetin e kryer në fshatin Thanasaj nuk rezulton që të jetë kryer ky raportim, në mënyrë që ai të trajtohej si gjithë aktivitetet e tjera nga ana e KQZ në lidhje me faktin nëse ishte aktivitet i ndaluar apo jo. Është pikërisht ky mosveprim i Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC, që e ngarkon atë me përgjegjësi administrative, në kuptim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, si dhe të pikës 4 të nenit 4 dhe pikës 1 të nenit 10 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Më konkretisht, pika 1 e nenit 10 të këtij vendimi parashikon se **“1. Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën veprë penale, dënohen nga Komisionieri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.**

Veprimtaria në fshatin Thanasaj ka qenë publike dhe AKMC ka pasur detyrimin për raportim, në përputhje me pikën 1 të nenit 92, të Kodit Zgjedhor. Sipas pikës 2 të të njëjtit nen *“raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv)”*. Për AKMC, personi përgjegjës është Drejtori i Përgjithshëm. Ai është person i ngarkuar me detyra në kuptimin e pikës 1, të nenit 171 të Kodit Zgjedhor. Në vendimmarrjen e tij, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk e ka trajtuar nëse veprimtaria e zhvilluar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC është e tillë që duhet të raportohet apo jo.

Raportimi i veprimtarive të institucioneve në periudhën e ndalimit është një mekanizëm kyç i Kodit Zgjedhor për të penguar keqpërdorimin e burimeve shtetërore dhe për të ndihmuar KQZ-në që të ruajë barazinë mes palëve në garë, nëpërmjet ndalimit të veprimtarive publike, të cilat kërkohet të zhvillohen në kundërshtim me rregullat e vendosura nga Kodi. Duke mos raportuar veprimtarinë e AKMC, Drejtori i Përgjithshëm i kësaj Agjencie ka penguar Komisionerin që të shqyrtojë paraprakisht ligjshmërinë e kësaj veprimtarie dhe të urdhërojë eventualisht ndalimin e saj. Masa e sanksionit që mund të vendoset, brenda limiteve të përcaktuara nga pika 1 e nenit 171 të Kodit Zgjedhor, duhet të marrë në konsideratë rëndësinë e posaçme të marrëdhënies juridike të cënuar, sikurse duhet të çmojë drejt edhe faktin se mekanizmi ligjor që mbron interesin publik

zgjedhor nga keqpërdorimi i burimeve shtetërore është ende në fazën fillestare të zbatimit dhe se, në shumicën e rasteve, cënimi vjen jo nga keqdashja, por nga keqkuptimi ose mosnjohja e detyrimit.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në arsyetimin e mësipërm ligjor dhe bazuar në shkronjën “dh”, të pikës 1 dhe në pikën 3, të nenit 21 të Kodit Zgjedhor, KAS-i me shumicë votash

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës nr.3, datë 15.07.2022 të Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj kandidates për kryetare të Bashkisë Lushnjë, zj. Eriselda Sefa dhe vendosjen e sanksionit administrativ mbështetur në pikën 1, të nenit 172 të Kodit Zgjedhor në vlerën 100,000 (njëqindmijë) Lekë.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako, mbështetur në pikën 1, të nenit 171 të Kodit Zgjedhor në vlerën 25,000 (njëzet e pesëmijë) Lekë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Ledio BRAHO - Relator

Elvin LAKO - Anëtar (kundër)

Elvis ÇEFA - Anëtar



Iirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar (kundër)

